

Rekomandim: Shuma totale e pagesave tuaja çdo muaj ("borxhi mujor" i juaj) nuk duhet të kalojë 30-40% të të ardhurave tuaja mujore!  
Me këtë ju mund të jeni të sigurt që ju keni para të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet mujore të familjes tuaj, kështu që ju mund të ballafaqoheni me të gjitha problemet e papritura.



Artani fiton 300 euro në muaj. Ai tashmë përdor kredi dhe paguan 65 euro në muaj. Ai dëshiron një kredi të re prej 500 eurosh për të blerë një frigorifer. Do të duhet të paguaj edhe 50 euro në muaj, gjegjësisht 115 euro në muaj, duke përfshirë edhe normën e interesit. A është ky një vendim i mirë?

Përgjigje: Le të themi se të ardhurat mesatare mujore të Artanit janë 300 euro. Limiti i tij mujor i kredisë është rreth 30%, ose 90 euro.

Meqë tashmë paguan 65 euro në muaj, ai mund të përballojë vetëm edhe 25 euro. Pra, nuk është një ide e mirë për të marrë kredi të re.

Tani llogaritni kapacitetin tuaj (mundësitë tuaja) për huamarrje:

Të ardhurat mesatare mujore: \_\_\_\_\_

30% nga të ardhurat mujore: \_\_\_\_\_

Borxhi aktual: \_\_\_\_\_

Edhe sa mund të përballoni që të huazoni? \_\_\_\_\_



## ÇKA DUHET TË DIMË PARA SE TË MARRIM KREDI



Kredi janë paratë që i marrim hua, me detyrimin për t'i kthyer në kohë së bashku me interesin. Kreditë mund të merren nga burime formale - institucione të rregulluara (p.sh. bankat, institucionet mikro financiare dhe institucionet e tjera financiare) dhe burime joformale (p.sh. miqtë dhe të afërmit). Institucionet e rregulluara janë nën rregulloren dhe mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

**Norma e Interesit:** Përqindja e shumës totale të kredisë të cilën e paguan huamarrësi për përdorimin e parave të huazuara dhe zakonisht paguhet në bazë mujore.

**Norma Efektive e Interesit:** Norma totale e interesit, e cila i përfshin të gjitha shpenzimet e kredisë (kredia plus norma e interesit, shpenzimet administrative).

**Shuma e kredisë:** Shuma të cilën mund ta merrni hua.

**Afati për pagesën e kredisë:** Periudha kohore brenda të cilës duhet patjetër të kthehen mjetet e kredisë.

**Komisionet/Tarifat:** Shpenzimet administrative, shpenzimet tjera lidhur me kredinë (sigurimi i kredisë, sigurimi i hipotekës).

**Kolaterali/Mbulesa:** Kolaterali/Mbulesa i/e nevojshëm/me që e leni peng që ju të mund të merrni kredi. Banka mund të ju kërkojë kolateral/mbulesë të caktuar, pëlqim të garantuesit ose ndalim administrativ që të mund të merrni kredi.



Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Rr. Garibaldi, Nr. 33. Prishtinë. Kosovë.  
[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Plani për pagesë:** Intervali i pagesës së kredisë (p.sh. mujore).

**Penalizimet (tarifat ndëshkuese):** Banka mund t'i përdorë për vonesë ose shlyerje të parakohshme të kredisë.

**Grejs-periodha:** (periudha e mospagimit) është periudha kur paratë janë në dispozicion të huamarrësit, por shlyerja ende nuk ka filluar. Është me rëndësi për klientët që të specifikohet në kontratë, nëse ngarkohet interesi gjatë Grejs periudhës.

### Si të bëni krahasimin ndërmjet kredive të ndryshme?

A mendoni se çmimi i kredisë përbëhet vetëm nga norma e interesit? Mendoni përsëri. Duhet të jeni të vetëdijshëm për shpenzimet e tjera lidhur me marrjen e kredisë, siç janë të dhënat për miratimin e kredisë, të dhënat për aplikim për kredi, shpenzimet e vlerësimit të kolateralit/mbulesës dhe të tjera.

Të llogarisim shpenzimet totale të dy kredive të ofruara nga dy banka të ndryshme. Në këtë shembull, shumën e kredisë si dhe periudhën e pagimit janë të njëjta, ndërkohë norma e interesit dhe të dhënat janë të ndryshme.

*Shembull: Banka A ofron kredi prej 1000 euro me periudhë shlyerje prej 12 muajsh me normë vjetore interesi prej 10%. Gjithashtu paguan 100 euro komision shtesë për shpenzimet tjera.*

*Banka B ofron kredi prej 1000 euro, me periudhë shlyerje prej 12 muajsh me normë vjetore interesi prej 8.5% dhe paguan 150 euro për shpenzimet tjera.*

Që t'i krahasoni këto dy oferta, patjetër t'i llogaritni shpenzimet totale të kredisë (norma e interesit dhe shpenzimet administrative).

	Banka A	Banka B
Norma e interesit që duhet të paguhet	10% $1000 * 10\%$ = 100 euro	8,5% $1000 * 8,5\%$ = 85 euro
Shuma totale duke përfshirë edhe shpenzimet administrative	$100 + 100$ = 200 euro	$85 + 150$ = 235 euro



Siç mund të shihni, kredia që ofron banka B është më e shtrenjtë, edhe përkundër asaj se norma e interesit është më e ulët. U befasuat?

Regullat për huamarrje të mençur: Mësoni ato, para se të shkoni në bankë

- ✓ Definoni qartë qëllimin tuaj. Për çka ju nevojiten paratë? Sa? Dhe deri kur?
- ✓ Mendoni nëse me të vërtetë tani keni nevojë për kredi (para), apo blerja mund të shtyhet, derisa të kurseni para të mjaftueshme.

NGA INSTITUCIONI JUAJ FINANCIAR KËRKONI TË GJITHA INFORMACIONET PËR **SHPENZIMET TOTALE TË KREDISË**. KËSHTU DO TË MUND TË BËNI KRAHASIM NDËRMJET PRODUKTEVE TË NDRYSHME TË KREDISË.

**MBAJ MEND:** ËSHTË MË LEHTË TË KRAHASOHEN SHPENZIMET PËR KREDI TË NDRYSHME TË CILAT KANË VLERË TË NJËJTË TË KREDISË DHE KUSHTË TË NJËJTA.

- ✓ Bëni llogari. Në buxhetin tuaj vlerësoni nevojat tuaja që do të mund t'i paguani, sa më saktë që është e mundur.
- ✓ Llogarit të ardhurat tuaja të tanishme dhe të ardhshme, shpenzimet dhe kursimet.
- ✓ Kërkoni këshilla nga konsulentët, familja, apo partnerët të ngushtë të biznesit.

### Çka është mbi-borxhi/mbingarkesa me borxh?

Themi se njerëzit e kanë tejkaluar borxhin, kur ata nuk janë në gjendje të shlyejnë borxhet e tyre në kohë dhe në përputhje me marrëveshjet.

### Si të shmangët mbingarkesa me borxh?



- 1) Lexojeni kontratën për kredi. Kushtoni kujdes shumë, afatit të shlyerjes, komisioneve, normës së kredisë, pjesëve që kanë të bëjnë me penalizime.
- 2) Filloni me kredi të vogla.
- 3) Bisedoni me bankierin para se të lidhni kontratë për kredi, që të jeni të sigurt se ajo kredi është në të vërtetë për ju.
- 4) Duhet të jeni të sqartë me bankierin - në të kundërtën mund të merrni kredi të cilën nuk do të mund ta ktheni.
- 5) Shfrytëzoni kredinë për atë qëllim për të cilin është marrë.
- 6) Mos e paguani kredinë e tanishme me kredi të reja.
- 7) Mos huazoni nga burime joformale (fajdexhinjë).

- 8) Tregoni institucionit tuaj financiar në qoftë se mendoni se do të keni probleme me shlyerjen.
- 9) Mos lejoni që dikush tjetër të bëjë marrëveshje për kredinë tuaj.
- 10) Mos e ndani kredinë tuaj me persona të tjerë. Nëse ata refuzojnë që ta paguajnë, ju do jeni përgjegjës për tërë shumën.
- 11) Mos u mbështetni tek garantuesit, mbështetuni tek aftësia juaj për ta shlyer kredinë.
- 12) Mos u bëni garantues të dikujt që nuk e njihni mirë - ju do jeni përgjegjës nëse ata s'do të mund ta kthejnë kredinë.
- 13) Nëse ndjeni se keni qenë të dëmtuar nga ana e institucionit financiar, keni të drejtë të iniconi procedura të caktuara të ankimit.

Asnjëherë mos i jepni të holla bankierit për shlyerjen e kredisë pa marrë vërtetim! Të gjitha paratë që do të paguani në bankë duhet të paraqiten qartë në vërtetim. Nëse bankieri nuk ua jep vërtetimin, refuzoni që të paguani!

### Çfarë ndodh në qoftë se ju nuk mund të paguani në kohë?

- do të rrezikoni të humbni pasurinë tuaj që është vendosur si kolateral/mbulesë;
- do ta humbni mundësinë për të marrë kredi të tjera;
- do të rrezikoni që të keni një histori të keqe kredie në Regjistrin e Kredive;
- do të humbni vetëbesimin;
- familja dhe partnerët e biznesit do ta humbasin besimin tek ju;
- do të keni kokëdhembje me noterët, përmbaruesit dhe gjykatat.



Huazoni me mençuri: kreditë mund të jenë të dobishme, por edhe të rrezikshme.